



Kolegji AAB

KOLEGJI AAB
AAB COLLEGE
Prishtinë
Nr. 672/25 data: 08.10.2025

R R E G U L L O R E **PËR KOMPENSIMIN E MËSIMDHËNËSVE**

Prishtinë, Tetor 2025

Në bazë të nenit 16 të Statutit, nenit 4 të Rregullores së Punës të Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues me datën 08/10/2025 miraton këtë:

Rregullore për Kompensimin e Mësimdhënësve

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

Rregullorja për kompensimin e mësimdhënësve do të rregulloj dhe përcaktoj tarifat e kompensimit, normën e orëve, mbinormën, dallimet në tituj akademik dhe grada shkencore, kompensimin për pozita shtesë etj.

Neni 2

Stafi akademik

1. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në programet e studimit, lidhë kontratë punë me institucionin përmes së cilës së paku por pa u kufizuar përcakton dhe rregullon formën e angazhimit, norma e orëve të mësimi, pagesën, të drejtat dhe detyrimet dhe çështje tjera me rëndësi për rregullimin e marrëdhënies së punës.
2. Stafi akademik mund të angazhohet në mësimdhënie me normë të plotë ose me gjysmë normë.

Neni 3

Kompensimi i stafit akademik me normë të plotë

1. Stafi akademik me normë të plotë do të angazhohet në ligjërata, ushtrime, mentorim të kandidatëve në studime master, mentorim të kandidatëve në studime bachelor, pjesëmarrje në këshilla mësimore, pjesëmarrje në komisione të veçanta profesionale, pjesëmarrje në komisione recenzuese etj.
2. Norma e angazhimit të stafit akademik:
 - 2.1. Norma e angazhimit dhe pagesa e mësimdhënësit me gradën akademike:
Profesor i rregullt

Tabela 1

Titulli: Profesor i rregullt			
<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e shërbimit</i>	<i>Limiti i normës, mbinormës dhe angazhimit</i>	<i>Pagesa</i>
1.	Norma e plotë e orëve të mësimi në javë	deri 8 orë ligjërata	1,500.00 €
2.	Mbinorma e lejuar e orëve të mësimi në javë	deri 4 orë ligjërata	25.00 €
3.	Mentorimi i kandidatëve në studime bachelor	deri 10 kandidatë brenda vitit akademik	50 € për një kandidat (30 mentori, 10 kryetari, 10 anëtar)
4.	Mentorimi i kandidatëve në studime master	deri 10 kandidatë brenda vitit akademik	Mentor: 200 € Kryetar i komisionit: 70 € Anëtar i komisionit: 50 €

2.2. Norma e angazhimit dhe pagesa e mësimdhënësit me gradën akademike:
Profesor i asocuar

Tabela 2

Titulli: Profesor i asocuar			
<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e shërbimit</i>	<i>Limiti i normës, mbinormës dhe angazhimit</i>	<i>Pagesa</i>
1.	Norma e plotë e orëve të mësimi në javë	deri 8 orë ligjërata	1,350.00 €
2.	Mbinorma e lejuar e orëve të mësimi në javë	deri 4 orë ligjërata	25.00 €
3.	Mentorimi i kandidatëve në studime bachelor	deri 10 kandidatë brenda vitit akademik	50 € për një kandidat (30 mentori, 10 kryetari, 10 anëtar)
4.	Mentorimi i kandidatëve në studime master	deri 10 kandidatë brenda vitit akademik	Mentor: 200 € Kryetar i komisionit: 70 € Anëtar i komisionit: 50 €

2.3. Norma e angazhimit dhe pagesa e mësimdhënësit me gradën akademike:
Profesor asistent

Tabela 3

Titulli: Profesor asistent			
<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e shërbimit</i>	<i>Limiti i normës, mbinormës dhe angazhimit</i>	<i>Pagesa</i>
1.	Norma e plotë e orëve të mësimi në javë	deri 8 orë ligjërata	1,200.00 €
2.	Mbinorma e lejuar e orëve të mësimi në javë	deri 4 orë ligjërata	25.00 €
3.	Mentorimi i kandidatëve në studime bachelor	deri 10 kandidatë brenda vitit akademik	50 € për një kandidat (30 mentori, 10 kryetari, 10 anëtar)
4.	Mentorimi i kandidatëve në studime master	deri 10 kandidatë brenda vitit akademik	Mentor: 200 € Kryetar i komisionit: 70 € Anëtar i komisionit: 50 €

2.4. Norma e angazhimit dhe pagesa e ligjëruesit me gradë shkencore:
Doktor i shkencave

Tabela 4

Titulli: Dr.sc. Ligjërues			
<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e shërbimit</i>	<i>Limiti i normës, mbinormës dhe angazhimit</i>	<i>Pagesa</i>
1.	Norma e plotë e orëve të mësimi në javë	deri 8 orë ligjërata	1,000.00 €
2.	Mbinorma e lejuar e orëve të mësimi në javë	deri 4 orë ligjërata	20.00 €
3.	Mentorimi i kandidatëve në studime bachelor	deri 10 kandidatë brenda vitit akademik	50 € për një kandidat (30 mentori, 10 kryetari, 10 anëtar)
4.	Mentorimi i kandidatëve në studime master	deri 10 kandidatë brenda vitit akademik	Mentor: 200 € Kryetar i komisionit: 70 € Anëtar i komisionit: 50 €

- 2.5. Norma e angazhimit dhe pagesa e ligjëruesit me gradë shkencore:
Mr.sc/MSc/MA

Tabela 5

Titulli: Mr.sc/MSc/MA/Dr.med: Ligjërues dhe bartës i programit të studimit			
<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e shërbimit</i>	<i>Limiti i normës, mbinormës dhe angazhimit</i>	<i>Pagesa</i>
1.	Norma e plotë e orëve të mësimin në javë	deri 8 orë ligjërata	800.00 €
2.	Mbinorma e lejuar e orëve të mësimin në javë	deri 4 orë ligjërata	10.00 €
3.	Mentorimi i kandidatëve në studime bachelor me pagesë	deri 15 kandidatë brenda vitit akademik	50 € për një kandidat (30 mentori, 10 kryetari, 10 anëtar)

- 2.6. Norma e angazhimit dhe pagesa e asistentit me gradë shkencore:
Mr.sc/MSc/MA

Tabela 6

Titulli: Mr.sc/MSc/MA/Dr.med			
<i>Nr.</i>	<i>Kategoria e shërbimit</i>	<i>Limiti i normës, mbinormës dhe angazhimit</i>	<i>Pagesa</i>
1.	Norma e orëve të mësimin në javë	deri 10 orë	500.00 €
2.	Norma e orëve të mësimin në javë	prej 10 deri 14 orë	600.00 €
3.	Norma e orëve të mësimin në javë	mbi 14 orë	700.00 €

Neni 4

Rregulla të angazhimit të stafit akademik me normë të plotë

1. Mësimdhënësit me normë të plotë, fillimisht i plotësohet norma me orë të ligjëratave, nëse kjo nuk arrihet, atëherë lejohet që t'i plotësohet norma edhe me orë të ushtrimeve.
2. Mësimdhënësit me normë të plotë, në rast se në ndonjërin prej semestrave nuk arrihet t'i plotësohet norma e plotë, atëherë lejohet që në semestrin tjetër të t'i plotësohet norma e orëve duke e ngarkuar për pjesën e mbetur nga semestri i kaluar.
3. Dekanati në koordinim me rektoratin është i obliguar që të sigurojë fondin e plotë të orëve për mësimdhënësin.
4. Nëse mësimdhënësi refuzon plotësimin e normës më orë të caktuara të ligjëratave apo ushtrimeve, atëherë pagesa i bëhet proporcionalisht me fondin e orëve që e mban.
5. Nëse për shkak të grupeve të studentëve, mësimdhënësit nuk mund t'i plotësohet norma e orëve nga lëndët e fushës së specializimit të tij, atëherë mësimdhënësi do të kompensohet në proporcion me fondin e orëve të mbajtura.
6. Kalkulimi i mbinormës bëhet në baza mujore dhe kompensohet çdo muaj apo në fund të semestrit ashtu si vendoset nga Zyra e financave dhe vetëm pas plotësimit të normës brenda çdo jave.

Neni 5

Angazhimi i stafit akademik me gjysmë normë

1. Stafit akademik me gjysmë normë mund të angazhohet në ligjërata, ushtrime, mentorim të kandidatëve në studime master, mentorim të kandidatëve në studime bachelor, pjesëmarrje në komisione recenzuese, sipas kriterëve dhe propozimeve të fakultetit.
2. Angazhimi i stafit akademik me gjysmë normë:
 - 2.1. Norma e angazhimit dhe pagesa e mësimdhënësit me gradë akademike:

Tabela 7

Mësimdhënësi i angazhuar		
Nr.	Titulli akademik, shkencor apo forma e angazhimit	Vlera e orës ose kompensimi mujor
1.	Prof.dr.	50.00 €
2.	Prof.asoc.dr.	30.00 €
3.	Prof.ass.dr.	25.00 €
4.	Dr.sc.	25.00 €
5.	Dr.med, specialist	25.00 €
6.	Mr.sc.; MSc; MA, Dr.med	20.00 €
7.	Mentori klinik	160.00 €

3. Mësimdhënësit të angazhuar me gjysmë normë i takon kompensimi sipas tabelës nga ky nen.
4. Mësimdhënësi i angazhuar me gjysmë normë mund të mbajë deri në 4 orë ligjërata në javë.
5. Kompensimi i mësimdhënësit të angazhuar me gjysmë normë bëhet çdo muaj apo në fund të semestrit ashtu siç vendos Zyra e financave.

Neni 6

Angazhimi i profesorëve vizitorë

1. Profesorët vizitorë mund të angazhohen me propozim të Dekanit të fakultetit dhe me miratim të Rektorit.
2. Propozimin për angazhimin e profesorit vizitor mund ta bëjë edhe profesori i lëndës. Edhe në këtë rast propozimi i përcillet Dekanit të fakultetit.
3. Kompensimi i profesorëve vizitorë bëhet sipas tabelës në vijim:

Tabela 8

Nr.	Profesori vizitor	Vlera e orës
1.	Profesorë vizitorë nga Kosova	50.00 €
2.	Ligjërues të jashtëm nga industria	50.00 €
3.	Profesorë vizitor nga rajoni	80.00 €
4.	Profesorët vizitorë nga universitetet jashtë rajonit (Evropa Perëndimore)	100.00 €
5.	Profesorët vizitorë nga universitet e SHBA-së	150.00 €

- Profesorit vizitor nga pika 4 dhe 5 e tabelës 8, i mbulohen edhe shpenzimet e udhëtimit.

Neni 7 Kompensimi për pozita shtesë

- Stafi akademik mund të zgjidhet apo të emërohet në pozita udhëheqëse dhe për atë pozitë i takon kompensim shtesë.
- Mësimdhënësi i zgjedhur apo i emëruar në një pozitë shtesë, do të kompensohet si në tabelën në vijim:

Tabela 9

Nr.	Pozita	Pagesa shtesë
1.	Rektor	1000 €
2.	Prorektor	600 €
3.	Dekan	500 €
4.	Prodekan	300 €
5.	Drejtor i degës	500 €
6.	Koordinator për mësim	300 €
7.	Udhëheqës i zyrës për sigurim të cilësisë	500 €
8.	Zyrtar për sigurim të cilësisë	250 €

Neni 8 Detyrat dhe përgjegjësitë

- Detyrat dhe përgjegjësit e mësimdhënësit janë të rregulluara me rregullore të veçantë dhe ato inkorporohen edhe në kontratën e punës.
- Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësit janë të fokusuara në punë akademike, punë kërkimore dhe projekte dhe punë administrative.
- Ngarkesa e mësimdhënësit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiive duhet të jetë sipas kësaj përqindje:
 - 60 % punë akademike
 - 20 % punë kërkimore dhe projekte dhe
 - 20 % punë administrative.

Neni 9 Kontrata me mësimdhënësin

- Kontratat e mësimdhënëseve lidhen për një semestër, një vit akademik apo për 3 vite akademike.
- Një semestër përfshinë periudhën pesë (5) mujore të ndarë në semestrin dimëror dhe në semestrin veror.
 - Semestrin dimëror përfshinë muajt tetor, nëntor, dhjetor, janar dhe shkurt.
 - Semestrin veror përfshinë muajt mars, prill, maj, qershor dhe shtator.

3. Një vit akademik përfshinë periudhën 12 mujore duke filluar nga 1 tetori deri 30 shtator.
4. Mësimdhënësi me normë të plotë lidhe kontratë për një periudhë kohore prej një deri katër vite akademike, por më së largu deri në skadimin e akreditimit të programit të studimit në të cilin është i angazhuar.
5. Thirrjet akademike të cilat fitohen nga mësimdhënësi, nuk kanë efekte juridike në kohëzgjatjen e kontratës.

Neni 10 **Shkëputja e Kontratës**

1. Shkëputja e kontratës mund të bëhet për arsye të ndryshme, por së paku dhe pa u kufizuar në arsyet e theksuara në pikën 2 të këtij neni.
2. Shkëputja e kontratës mund të bëhet:
 - a. Me marrëveshje me shkrim në mes palëve kontraktuese;
 - b. Në rastet e rënda të sjelljes joetike e joprofesionale që cenojnë rëndë imazhin e punëdhënësit dhe marrëdhëniet ndërkolegjiale;
 - c. Shkeljeve të rënda të detyrave dhe përgjegjësisë, rendit shtëpiak dhe akteve ligjore të institucionit;
 - d. Mos përmbushjes së kënaqshme të detyrave të punës nga ana e punëmarrësit;
 - e. Me skadim të kontratës (neni 2).
 - f. Me mos aprovim si bartës i programit përkatës nga Agjencia e Kosovës për Akreditim;
 - g. Me humbjen e akreditimit të programit të studimit;
 - h. Në rast të aplikimit për punë në ndonjë institucion tjetër;
 - i. Sipas fuqisë ligjore.

Neni 11 **Dorëheqja e Kontratës**

1. Mësimdhënësi nëse dëshiron të jap dorëheqje, për shkak të specifikave të profesionit dhe interesit të studentëve, duhet ta njoftoj institucionin së paku tre (3) muaj më herët.
2. Punëdhënësi ka të drejtë për mos vazhdimin e kontratës apo edhe përfundimin e parakohshëm të saj me një njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 12 **Dënimi kontraktor**

1. Mësimdhënësi obligohet që detyrimet e tij t'i përmbush dhe të garantoj institucionin se përderisa është i angazhuar me kontratë të vlefshme, nuk do të aplikoj për t'u punësuar në ndonjë institucion tjetër që të themeloj marrëdhënie pune me normë të plotë.
2. Në rast të kundërt nga paragrafi 1, institucioni ka të drejtë që në mënyrë të njëanshme:
 - a. Ta ndryshoj kontratën sa i përket çmimit;

- b. Ta ndryshoj statusin e mësimdhënësit nga kontrata me marrëdhënie pune me normë të plotë në kontratë me marrëdhënie të punës me angazhim;
 - c. Ta pezullojë përmbushjen e kontratës;
 - d. Të shkëpusë kontratën në tersi;
 - e. Të kontaktoj institucionin tjetër që të deklarohet lidhur me aftësitë profesionale dhe sjelljet etike.
3. Aplikimi i mësimdhënësit në ndonjë institucion tjetër për të themeluar marrëdhënie të rregullt pune gjatë kohëzgjatjes së kontratës aktive, paraqet shkelje të kushteve të kontratës dhe obligohet që institucionit në emër të dënimit kontraktor t'i paguaj shumën e barasvlershme të tri pagave.

Neni 13

Sanksionet mosrespektim të detyrimeve akademike

1. Mësimdhënësi i cili nuk i mban orët e mësimi, ushtrimeve, kujdestarisë, provimet, konsultimet, pa arsytim të aprovuar nga dekanati, do të sanksionohet në lartësi të shumës prej 100 € për një orë të humbur.
2. Mësimdhënësi i cili refuzon pa arsye të bëhet anëtarë i komisionit recensues, apo nënshkruar recensionin në kundërshtim me Statutin, Rregulloren përkatëse të institucionit dhe me ligjet e aplikueshme, do të paraqitet në Komision të Etikës për shkelje etike.
3. Mësimdhënësi i zgjedhur i cili pa arsye nuk merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Mësimor, Këshillit për Studime Master, Komisionet profesionale për udhëheqjen e kandidatit, dhe në komisione tjera që ftohet, do të paraqitet në Komision të Etikës për shkelje etike.
4. Dekani i Fakultetit, obligohet që të kujdeset për zbatimin e dispozitave nga paragrafi 1 deri 3. Nëse Dekani dështon në raportimin apo përmbushjen e obligimeve të tij sipas këtyre paragrafëve, ndëshkimi financiar përkatës do të aplikohet për Dekanin e fakultetit.
5. Sanksionet e përcaktuara në paragrafin 1, 2 dhe 3, aplikohen vetëm për stafin akademik me normë të plotë, ndërsa për stafin akademik me normë jo të plotë aplikohen vetëm sanksionet nga paragrafi 1.

Neni 14

Publikimet shkencore dhe sanksionet

1. Çdo anëtar i stafit akademik është i obliguar që, brenda një viti akademik, të publikojë së paku një (1) punim shkencor në revista shkencore të indeksuara në Scopus ose Web of Science.
2. Publikimi i punimit sipas paragrafit 1 të këtij neni përbën kriter të detyrueshëm për vlerësimin e performancës akademike vjetore, e cila zhvillohet në muajin qershor të çdo viti.

3. Në rast se gjatë vlerësimit vjetor konstatohet se anëtari i stafit akademik nuk ka përmbushur obligimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, ndaj tij/saj zbatohet një sanksion financiar në shumën prej pesëqind (500) eurove, e cila i ndalet nga paga mujore pas miratimit të raportit të vlerësimit.
4. Zbatimi i sanksionit financiar sipas paragrafit 3 të këtij neni nuk përjashton përgjegjësitë e tjera disiplinore dhe administrative të përcaktuara në kontratën e punës dhe aktet e brendshme të institucionit.

Neni 15

Detyrimet e mentorit dhe anëtarëve të komisionit të studimeve master

1. Mentori i kandidatit dhe anëtarët e komisionit janë të obliguar t'i përmbushin detyrimet e tyre akademike dhe administrative brenda afateve të përcaktuara me Rregulloren për studime master dhe aktet e tjera përkatëse të institucionit.
2. Nëse mentori ose ndonjë anëtar i komisionit nuk i kryen obligimet e përcaktuara brenda afateve të caktuara, dhe kjo vonesë konstatohet me shkrim nga dekani i fakultetit, ndaj personit përgjegjës zbatohet një sanksion financiar në shumën prej njëqind (100) eurove.
3. Sanksioni financiar i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni zbatohet për çdo rast të shkeljes së afatit dhe i ndalet nga paga mujore pas miratimit të raportit nga dekani.
4. Zbatimi i këtij sanksioni nuk përjashton përgjegjësitë e tjera disiplinore dhe administrative të parashikuara në kontratën e punës dhe aktet e brendshme të institucionit.

Neni 16

Sanksioni për mosrespektimin e afateve

1. Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara për komunikimin e rezultateve të provimeve, përmbylljen e raportit në sistemin elektronik dhe dorëzimin e raportit përfundimtar në administratë, profesori i lëndës sanksionohet me një ndëshkim financiar në shumën prej pesëdhjetë (50) eurove për secilin rast të shkeljes së konstatuar.
2. Konstatimi i mosrespektimit të afateve bëhet nga administrata dhe konfirmohet nga dekani i fakultetit.
3. Zbatimi i këtij sanksioni nuk përjashton përgjegjësitë e tjera disiplinore dhe administrative të parashikuara në kontratën e punës dhe aktet e tjera të institucionit.

Neni 17

Paraqitja e përkatësisë institucionale

1. Personeli akademik dhe joakademik është i obliguar që, në të gjitha paraqitjet profesionale publike dhe akademike, përfshirë publikimet shkencore, konferencat, simpoziumet, tryezat dhe ngjarjet e ngjashme, prezantimet dhe deklaratimet që lidhen

me aktivitetin arsimor ose shkencor, të tregojë përkatësinë e tij në institucionin “Kolegji AAB”.

2. Personeli i rregullt është i detyruar që në profilet e tij në rrjetet profesionale elektronike si: *LinkedIn; Academia.edu; ResearchGate; Google Scholar* dhe çdo platformë tjetër elektronike të ngjashme që përdoret për prezantim akademik ose profesional, të identifikojë punëdhënësin e tij primar si “Kolegji AAB”.
3. Personeli nuk e ka detyrim por rekomandohet që të bëjë identifikimin e punëdhënësit në rrjete sociale personale (p.sh. Facebook, Instagram, Twitter, TikTok), përveç rasteve kur ato përdoren për komunikim profesional, akademik ose shkencor.
4. Deklarimet personale që nuk lidhen me aktivitetin profesional ose akademik, përfshirë ato me përmbajtje politike, private apo joprofesionale, nuk përfshihen në këtë obligim.
5. Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë nen përbën shkelje të dispozitave të rregullores dhe sanksionohet me një ndëshkim financiar në shumën prej njëqind (100) eurove për çdo rast të konstatuar.

Neni 18 **Zëvendësimi i orëve**

1. Mësimdhënësi obligohet të lajmërojë dekanin e fakultetit për mungesën në proces mësimor një javë më herët dhe ajo orë duhet të zëvendësohet paraprakisht, ose pas datës së rregullt, vetëm pas sigurimit të aprovimit nga dekani i fakultetit.
2. Nuk lejohet ndërrimi i orarit të ligjëratave nga ana e mësimdhënësit përveç në raste të jashtëzakonshme dhe kjo duhet bërë në harmoni të plotë me dekanatin.
3. Pa sigurimin e pëlqimit të dekanatit, nuk lejohet ndërrimi i orarit të ligjërates qoftë edhe në marrëveshje me studentët.
4. Zëvendësimi i orëve bëhet sipas planit të aprovuar nga dekani i fakultetit dhe nuk ka asnjë efekt financiar në pagën e mësimdhënësit.


Neni 19 **Dispozitat Kalimtare**

1. Të gjitha shumat e përcaktuara me këtë rregullore nënkuptojnë shumat bruto dhe brenda tyre përfshihen të gjitha taksat dhe tatimet e aplikueshme.
2. Kjo Rregullore mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të saj.
3. Me nënshkrimin e kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 872/2024 e datës 24/10/2024/ për Kompensimin e Mësimdhënësve.

Neni 20
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi me datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues dhe nënshkrimin nga Kryetari.

Prishtinë, Tetor 2025


Këshilli Drejtues
Albulena Ramadani, Kryetare





Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës,
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797
Mail: info@aab-edu.net;
www.aab-edu.net

Ref. nr. 671/2025

Prishtinë, 08.10.2025

Në bazë të nenit 16 të Statutit, nenit 4 të Rregullores së Punës të Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues, merr këtë:

V E N D I M

I. MIRATOHET Rregullorja për Kompensimin e Mësimdhënësve.

Një kopje e vendimit:

për: Rektorin
për: Prorektorët
për: Sekretarin
për: Arkivin

Abulena Ramadani,
Kryetare e Këshillit Drejtues

